

VENDIM
Nr. 924, datë 26.12.2012

**PËR LEJIMIN E SHOQËRISË “KESH” SHA TIRANË TË IMPORTOJË ENERGJI
ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN NGA DATA 1.1.2013 DERI MË 1.3.2013, PËR FURNIZIMIN E
KONSUMATORËVE TARIFORË DHE MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shoqërisë “KESH” sh.a. Tiranë të importojë energji elektrike, për periudhën nga data 1.1.2013 deri më 1.3.2013, për garantimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike në vend dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

2. Kostot financiare të importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, sipas pikës 1 të këtij vendimi, t’i faturohen shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. Tiranë.

3. Procedurat e importimit të energjisë elektrike nga ana e shoqërisë “KESH” sh.a. Tiranë, të bëhen në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për sigurimin e burimeve financiare për kryerjen e importit të energjisë elektrike nga shoqëria “KESH” sh.a. Tiranë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për importin e energjisë elektrike, të realizuar nga KESH sh.a., në periudhat e mëparshme.

5. Ngarkohen Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe shoqëria “KESH” sh.a. Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha